

MARRËVESHJE ADMINISTRATIVE**PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR MBROJTJEN SHOQËRORE**

Bazuar në paragrafin (1) të nenit 20 të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për Mbrojtjen Shoqërore të datës 25 Janar 2017 - autoritetet kompetente të të dy shteteve kontraktues për zbatimin e Marrëveshjes, bien dakord si vijon:

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1**Përkufizime**

(1) Në këtë Marrëveshje administrative termi “Marrëveshje” nënkupton Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për Mbrojtjen Shoqërore, të datës 25 Janar 2017.

(2) Termat e përdorura në këtë marrëveshje administrative kanë të njëjtin kuptim që u jepet në nenin 1 të Marrëveshjes.

Neni 2**Zyrat ndërlidhëse**

Zyra ndërlidhëse në kuptim të nenit 21 të Marrëveshjes janë

në Republikën e Shqipërisë:

- Instituti i Sigurimeve Shoqërore (**Sozialversicherungsinstitut**)

në Republikën e Austrisë:

- **Hauptverband der österreichischen Sozialversicherungsträger**,
(Federata austriake e Institucioneve të Sigurimeve Shoqërore)

Neni 3**Detyrat e zyrave ndërlidhëse**

(1) Zyrat ndërlidhëse zbatojnë detyrat e përcaktura në Marrëveshje si dhe në këtë marrëveshje administrative. Për zbatimin e Marrëveshjes dhe të kësaj marrëveshjeje administrative zyrat ndërlidhëse duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën dhe mundet të komunikojnë me njëra-tjetrën si dhe me personat e interesuar ose me të autorizuarit e tyre.

(2) Zyrat ndërlidhëse duhet të përcaktojnë formularët dhe procedurat e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje administrative dhe të shkëmbejnë informacione për institucionet kompetente.

(3) Zyrat ndërlidhëse duhet të bien dakord sa më shpejt të jetë e mundur për shkëmbimin elektronik të të dhënave, nëse kushtet e nevojshme teknike ekzistojnë në të dy shtetet kontraktuese.

PJESA II**PËRCAKTIME MBI DISPOZITAT E ZBATUESHME LIGJORE****Neni 4****Zbatimi i paragrafit (2) të nenit 6) dhe neneve 7 deri 10 të Marrëveshjes**

(1) Në rastet e parashikuara nga paragrafi (2) neni 6, dhe nenet 7 deri 10 të Marrëveshjes, institucioni kompetent i shtetit kontraktues dispozitat ligjore të të cilit duhet të zbatohen, me kërkesë, duhet të lëshojë një vërtetim (formular), i cili vërteton, se për personin në fjalë lidhur me punësimin përkatës, janë të zbatueshme këto dispozita ligjore.

(2) Ky vërtetim sipas paragrafit (1) lëshohet:

në Republikën e Shqipërisë:

- nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore

në Republikën e Austrisë:

- nga institucioni kompetent i sigurimeve shëndetësore;

PJESA III**ZBATIMI I RREGULLIMEVE TE VEÇANTA****Kapitulli 1****Sëmundja dhe barrëlidja****Neni 5****Dhënia e përfitimeve në para**

Institucionet kompetente përfitimet në para duhet t'ua paguajnë direkt përfituesve ose, sipas rastit, përfaqësuesve të tyre ligjorë.

Kapitulli 2**Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale****Neni 6****Dhënia e përfitimeve në para**

- (1) Institucionet kompetente përfitimet në para duhet t'ua paguajnë direkt përfituesve ose, sipas rastit, përfaqësuesve të tyre ligjorë.
- (2) Në lidhje me paragrafin (4) të nenit 20 të Marrëveshjes, institucionet kompetente kanë të drejtë të kërkojnë nga përfituesit ose, sipas rastit, përfaqësuesit e tyre ligjorë, dokumente që vërtetojnë (sidomos ato që vërtetojnë se personi është gjallë) mbi vazhimin e ekzistencës së kushteve për pagesën e përfitimeve në para.

Neni 7**Statistikat**

Institucionet kompetente të të dy shteteve kontraktuese duhet tu dërgojnë të dhëna statistikore zyraive ndërlidhëse respektive për pagësat e përfitimeve të kryera në shtetin tjetër kontraktues. Zyrrat ndërlidhëse respektive shkëmbejnë cdo vit statistikatat për këto pagesa.

Kapitulli 3**Pensionet e Pleqërisë, Invaliditetit, Familjare dhe përfitime të tjera që paguhën nga dega e sigurimit të pensioneve****Neni 8****Përpunimi i kërkesave për përfitim**

- (1) Në lidhje me paragrafin (2) të nenit 24 të Marrëveshjes, institucionet kompetente duhet të njoftojnë pa vonesë njëri-tjetritin për kërkesën për përfitim në lidhje me Kapitullin 3, të Pjesës së III.
- (2) Institucionet kompetente në vijim duhet t'i njoftojnë njëri - tjetrit edhe faktet e tjera të rëndësishme (duke përfshirë periudhat e sigurimit) për caktimin e përfitimit, dhe nëse është rasti, duke i bashkëngjitur ekspertizat mjeksore.
- (3) Konfirmimi (vërtetimi) i të dhënave personale të shënuara në formularë zëvendëson dërgimin e dokumenteve origjinale.
- (4) Institucionet kompetente duhet të informojnë njëri-tjetritin mbi vendimet në procesin e caktimit të përfitimit.

Neni 9**Pagesa e pensioneve dhe përfitimeve të tjera në para**

(1) Institucionet kompetente, pensionet dhe përfitimet në para duhet t'ua paguajnë direkt përfituesve ose, sipas rastit, përfaqësuesve të tyre ligjorë.

(2) Në lidhje me paragrafin (4) të nenit 20 të Marrëveshjes, institucionet kompetente kanë të drejtë të kërkojnë nga përfituesit ose, sipas rastit, përfaqësuesit e tyre ligjorë, dokumente që vërtetojnë (sidomos ato që vërtetojnë se personi është gjallë) mbi vazhdimin e ekzistencës së kushteve për pagesën e pensioneve dhe përfitimeve të tjera në para.

Neni 10**Statistikat**

Lidhur me pensionet dhe përfitime të tjera në para zbatohet përkatësisht neni 7.

PJESA IV**RREGULLIMET PERFUNDIMTARE**Neni 11Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

(1) Kjo marrëveshje administrative hyn në fuqi njëkohësisht me Marrëveshjen.

(2) Kjo marrëveshje zbatimi shfuqizohet bashkë me Marrëveshjen.

BËRË në Tiranë më _____, në dy origjinale, secili në gjuhen shqipe dhe gjermane dhe ku të dy tekstet janë njëloj autentike.

Për Republikën e Shqipërisë:

Për Republikën e Austrisë: